



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1662/Prot.
2

Tiranë, më 01/10 2014

U R D H E R

Nr. 11, datë 01/10/2014

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "Ministria e Arsimit dhe Sportit" (MAS), Tiranë,

K O N S T A T O V A:

Në zbatim të Urdhrit nr. 150 datë 29.09.2014 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer inspektimi administrativ pranë kontrolluesit "Ministria e Arsimit dhe Sportit" me objekt: *Zbatimi nga ana e kontrolluesit i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së procedurave të cilat do të zbatohen lidhur me plotësimin e formularit "Pyetësor i gjendjes së shëndetit të nxënësit".*

Inspektimi administrativ ka filluar kryesisht nga zyra e Komisionerit. "Ministria e Arsimit dhe Sportit" në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, është kontrollues publik, i cili përpunon të dhëna në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë në fushën e arsimit dhe edukimit në sistemin para-universitar, universitar dhe pas-universitar në Republikën e Shqipërisë.

Ministria e Arsimit dhe Sportit bazuar në Urdhrin Nr. 360, datë 15.09.2014 "Për plotësimin e materialeve didaktike të lëndës së edukimit fiziko-sportiv në sistemin arsimor para-universitar për vitin 2014-2015" të Ministrit të Arsimit dhe Sportit ka iniciuar procesin e shpërndarjes dhe plotësimit (nga ana e prindërve) të "Pyetësorit të gjendjes shëndetësore të nxënësit", në përputhje me "Platformën e edukimit fiziko-sportiv".

Kontrolluesi ka dërguar Urdhrin Nr. 360, datë 15.09.2014 "Për plotësimin e materialeve didaktike të lëndës së edukimit fiziko-sportiv në sistemin arsimor para-universitar për vitin 2014-2015" të Ministrit të Arsimit dhe Sportit së bashku me "Pyetësorin e gjendjes së shëndetit të nxënësit" pranë Drejtorive Rajonale Arsimore dhe Qendrave Arsimore në Rrethe. Gjithashtu kontrolluesi (MAS) ka përgatitur dhe ka shpërndarë pranë shkollave "Platformën e edukimit fiziko-sportiv" si dhe "Udhëzuesin për mësuesin e edukimit fizik" në të cilët përcaktohen rregulla mbi administrimin e procesit të plotësimit të:

- Pyetësorit të gjendjes së shëndetit të nxënësit
- Kartelës individuale të nxënësit

Në pikën e) Ruajtja dhe Arkivimi i të Dhënave të “Udhëzuesi për mësuesin fizik” është parashikuar se: *“Të dhënat personale të nxënësit, janë shumë të rëndësishme prandaj mënyra e ruajtjes dhe arkivimi i tyre, do të trajtohen sipas rregulloreve që do të pasojnë së shpejti këtë proces. Kartela individuale e nxënësit e shoqëruar me pyetësin familjar të plotësuar, do ta shoqërojnë nxënësin për gjatë gjithë jetës së tij shkollë dhe si e tillë, ajo do të ketë edhe vlera të rëndësishme studimore për vetë shoqërinë dhe shëndetin e popullatës”*.

Nëpërmjet “Pyetësit të gjendjes së shëndetit të nxënësit” kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale dhe sensitive si: Emri i nxënësit, mbiemri, datëlindja, emri dhe mbiemri i prindit, nr. tel/cel, dhe e-mailin, si dhe të dhëna shëndetësore në lidhje me gjendjen e nxënësit. Në pyetësor parashikohet edhe qëllimi i përpunimit të të dhënave personale të nxënësit i cili konsiston në institucionalizimin e një kulture bashkëkohore të marrëdhënieve midis familjes dhe shkollës, njohjes së gjendjes shëndetësore të nxënësit në mënyrë që të sigurohet mbrojtja dhe përmirësimi i shëndetit të tyre.

Gjithashtu në “Në kartelën individuale të nxënësit” kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale dhe sensitive si: Emri i nxënësit, mbiemri, datëlindja, gjinia, vendlindja, vendbanimi, profesioni i babait dhe i nënës si dhe të dhëna antropometrike (pesha trupore, lartësia, perimetri i belit etj).

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ, aktet ligjore dhe nënligjore të kontrolluesit (MAS) si dhe provat e tjera të administruara në dosje, vëren se:

1. Në zbatim të shkronjës d) të pikës 1) të nenit 5 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, kontrolluesi nuk ka parashikuar afate konkrete lidhur me kohën e mbajtjes së të dhënave të përpunuara në kuadër të administrimit të pyetësorëve dhe kartelave individuale të nxënësve.
2. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, kontrolluesi nuk ka informuar nëpërmjet “Pyetësit të gjendjes së shëndetit të nxënësit”, subjektet e të dhënave për personin/subjektin që do të përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tyre. Gjithashtu subjekti i të dhënave nuk është informuar (në përmbajtjen e pyetësit) për faktin që pyetësi nuk është i detyrueshëm për tu plotësuar.
3. Kontrolluesi (MAS) nuk ka njoftuar pranë Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale përpara fillimit të procesit të përpunimit të të dhënave personale të nxënësve si dhe shpërndarjes së këtij pyetësi. Në këtë kuadër është shkëlur pika 1) e nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, ku parashikohet detyrimi i çdo kontrolluesi publik ose privat për të njoftuar përpara se të fillojë përpunimin e ri.
4. Në zbatim të nenit 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, kontrolluesi nuk ka hartuar një rregullorë të brendshme lidhur me sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesi. Në të duhet të parashikohen masa konkrete sigurie, qëllimi i përpunimit, kategoritë e marrësve, metodat e përpunimit dhe mbrojtjes së dhënave, të drejtat e aksesit, koha e mbajtjes së të dhënave dhe mënyra e fshirjes së tyre nëse nuk janë më të nevojshme, rregulla mbi rruajtjen e konfidencialitetit, si dhe

rregulla mbi ndërgjegjësimin dhe trajnimin në lidhje me mbrojtjen e këtyre të dhënave, detyrimet e kontrolluesit dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al).

5. Gjithashtu në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, nuk u konstatua hartimi i një deklarate konfidencialiteti të detyrueshme për tu nënshkruar nga personat përgjegjës që do të aksesojnë të dhënat personale dhe sensitive të nxënësve.
6. Kontrolluesi nuk ka sjellë për mendim pranë Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Urdhrin Nr. 360, datë 15.09.2014 “Për plotësimin e materialeve didaktike të lëndës së edukimit fiziko-sportiv në sistemin arsimor para-universitar për vitin 2014-2015” të Ministrit të Arsimit dhe Sportit së bashku me “Pyetësorin e gjendjes së shëndetit të nxënësit” si dhe “Kartelën individuale të nxënësit”, në kundërshtim me shkronjën a) të pikës 1) të nenit 31 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe shkresën nr. 3268 prot, datë 16.10.2012 “Për bashkërendimin e projektakteve” drejtuar të gjithë Ministrave nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 5, 18, 21, 27, 28, 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe neneve 107-109 të K. Pr. Administrative :

URDHEROJ

- 1- Tërheqjen e menjëhershme nga kontrolluesi (MAS) të të gjithë “Pyetësorëve të gjendjes së shëndetit të nxënësve” si dhe “Kartelave individuale të nxënësve” të shpërndara nëpër shkolla e Drejtori Arsimore Rajonale, si dhe pezullimin e procesit të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale dhe sensitive të nxënësve, deri në momentin e plotësimit të detyrimeve ligjore në zbatim të shkronjës b), pika 1) e nenit 30 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.
- 2- Të parashikohen nga kontrolluesi (MAS) afate konkrete lidhur me kohën e mbajtjes së të dhënave personale dhe sensitive të përpunuara në kuadër të administrimit të pyetësorëve dhe kartelave, në zbatim të shkronjës d) të pikës 1) të nenit 5 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.
- 3- Informimin e subjekteve të të dhënave lidhur me personin/subjektin që do të përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tyre. Gjithashtu të informohet subjekti i të dhënave (në përmbajtjen e pyetësorit) për faktin që pyetësori nuk është i detyrueshëm për tu plotësuar, në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.
- 4- Kryerjen e përditësimit të njoftimit nga ana e kontrolluesit (MAS) në lidhje me përpunimin e ri të të dhënave të nxënësve me anë të “Pyetësorit të gjendjes së shëndetit të nxënësve” dhe “Kartelës individuale të nxënësit”, në zbatim të pikës 1) të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”

i ndryshuar, ku parashikohet detyrimi i çdo kontrolluesi publik ose privat për të njoftuar përpara se të fillojë përpunimin e ri.

- 5- Hartimin e një rregulloreje të brendshme lidhur me sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar.
- 6- Hartimin nga ana e Kontrolluesit (MAS) të deklaratave të konfidencialitetit, të detyrueshme për tu nënshkruar nga personat përgjegjës që do të aksesojnë të dhënat personale dhe sensitive të nxënësve, në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar.
- 7- Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (*dyzet e pesë*) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij Urdhri, me përjashtim të pikës 1 ku duhen marrë masa të menjëhershme nga kontrolluesi (MAS).
- 8- Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- 9- Me kalimin e afateve në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, sipas të cilit... "*Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji (duke vendosur sanksione me gjobë në rastet e konstatuara si kundërvajtjeve administrative) dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave*".
- 10- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI
